



## KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

### PROCES VERBAL

**Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Maj 2024**

**Data 24.05.2024 ora 15:00.**

**Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.**

#### **Rendi i dites:**

1. Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Prill 2024.
2. Projekt vendim për rishikimin e Vkb nr.32 datë 29.04.2024 të K.B "Për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit, me afat deri në 10 vite, të sipërfaqes prej 20 ha, pjesë e pasurisë nr.148/1, Zk nr.2993 e llojit " Kullotë ", në fshatin Plezhë, Nj.Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës "Për ndërtim parku fotovoltaik, aerogjeneratorë(stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)
3. Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 10(dhjetë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 92.34 ha, për park fotovoltaik(stacionet,objektet përkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin Gjader Kirë.
4. Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9(nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 0.1053 ha "Për qëllime shëndetësore,shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojërash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)në ngastren nr. 6 , ekonomia pyjore Karmë".
5. Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9(nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 0.5 ha "Për qëllime shëndetësore,shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojërash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)në ngastren nr. 3 b, ekonomia pyjore Gjader Mnelë".
6. Projekt vendim për dhënie në përdorim me afat deri në 10 vjet të sipërfaqes pyjore prej 10.246 ha, " Për park fotovoltaik(stacionet,objektet përkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin Gjader Kirë.
7. Projekt vendim për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për z. Pjeter Zefi dhe z. Paulin Bisha në programin e strehimit "Subvencionit të qirasë në tregun e lirë"

8. Raport mbi performancën ekonomiko-financiare dhe aktivitetin e shoqërisë “Zadrime Agrikulturë” shpk.

9. Të ndryshme.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Maj 2024, u zhvillua me datë 24.05.2024 ora 15.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z. Ardian Çelepija. Të pranishëm në sallë ishin 20 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z. Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e ditës dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 20 vota Pro.**

**Z. Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Prill 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj. Ilda Prendi -perfaqesuese e zyrës së ndihmës ekonomike, e cila relatton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se bazuar në fondet e kushtëzuara për muajin Prill 2024, të përfitojnë 140 familje, me 474.217 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Prill 2024 janë shpallur fitues, 1.038 familje, me fond 7.915.920 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 474.955 lekë.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro.**

**Z. Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për rishikimin e Vkb nr.32 datë 29.04.2024 të K.B ”Për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit, me afat deri në 10 vite, të sipërfaqes prej 20 ha, pjesë e pasurisë nr.148/1, Zk nr.2993 e llojit “ Kullotë “, në fshatin Plezhë, Nj. Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës “Për ndërtim parku fotovoltaiq, aerogeneratorë(stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)

Z. Ervis Shimaj i jep flalën për të relatuar për projekt vendimin Z. Ndoc Baqli-përgjegjes i zyrës së aseteve pranë Bashkisë Vau Dejës, i cili spjegon se për sipërfaqen e sipërcituar është marrë vendim nga Këshilli Bashkiak por institucioni i Prefektit Qarkut Shkoder e ka kthyer për plotesim



dokumentacioni vendimin dhe për këtë arsye e kemi sjellë për rishikim vendimin nr.32 sepse janë plotësuar dokumentat e kërkuara nga institucioni i Prefektit Qarkut Shkoder me te cilat jeni të pajisur edhe ju si këshilltarë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18vota Pro.**

*(Z.Pjeter Lleshi dhe Z.Florin Tanushi nuk marrin pjesë në votim dhe largohen nga salla e mbledhjes)*

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 10(dhjetë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 92.34 ha, për park fotovoltai(stacionet,objektet përkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin Gjader Kirë.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Mark Suli-inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vau Dejës, i cili shpjegon për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi baza ligjore per hartimin e projekt vendimit dhe se me date 22.05.2024 është realizuar dëgjese publike me banorët e fshatit Spathar dhe se te pranishmit kishin shprehur dakortesi per projekt vendimin.

Këshilli Bashkiak ka kompetencë që të vlerësojë dhënien apo jo në përdorim të pronave të Bashkisë.Dhënia në përdorim e kesaj siperfaqe sjell impakt pozitiv si per fshatin Spathar si dhe rritje të të ardhurave për Bashkinë.

Për sipërfaqen e mesiperme e cila do ti nënshtrohet procedures se konkurrimit publik, sipas legjislacionit në fuqi , do të zbatohet edhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “ Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytezim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca 1, pika 8/4..

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Mark Bisha pyet: Ku ndodhet kjo siperfaqe pyjore?

Z.Mark Suli pergjigjet:Kjo siperfaqe ndodhet mbi lagjen Spathar dhe se nuk prek asnjë pjese te tokave bujqesore.

Pyetje tjera nuk ka .Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18vota Pro**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:**

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9(nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 0.1053 ha “Për qëllime shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojërash, mjedise sportive, shplohëse, kulturore, etj) në ngastren nr. 6 , ekonomia pyjore Karmë”.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Mark Suli-inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vau Dejës, i cili spjegon për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit dhe se me date 08.05.2024 është realizuar dëgjese publike me banorët e fshatit Karmë dhe se te pranishmit kishin shprehur dakortesi për projekt vendimin.

Për sipërfaqen e mesiperme e cila do të nënshtrohet procedurës së prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, do të zbatohet edhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca 1, pika 8/4..

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9(nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 0.5 ha “Për qëllime shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojërash, mjedise sportive, shplohëse, kulturore, etj) në ngastren nr. 3 b, ekonomia pyjore Gjader Mnelë”.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Mark Suli-inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vau Dejës, i cili spjegon për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit dhe se me date 07.05.2024 është realizuar dëgjese publike me banorët e fshatit Gomsiqe dhe se te pranishmit kishin shprehur dakortesi për projekt vendimin. Për sipërfaqen e mesiperme e cila do të nënshtrohet procedurës së prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, do të zbatohet edhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca 1, pika 8/4.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.



Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

*.(Znj.Rregjinë Shelqetja nuk merr pjesë në votim)*

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për dhënie në përdorim me afat deri në 10 vjet të sipërfaqes pyjore prej 10.246 ha, “ Për park fotovoltai (stacionet,objektet përkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin Gjadër Kirë.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Mark Suli-inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit. Për sipërfaqen e mesiperme e cila do të nënshtrohet procedurës së konkurrimit publik, sipas legjislacionit në fuqi është zbatuar VKM nr.748 datë 01.12.2022 “për percaktimin e zonës, distancës dhe gjeresisë të brigjeve dhe burimeve ujore”, e cila ndodhet jashtë bregut të liqenit sipas pikës III.5, si dhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “ Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.

Gjithashtu dhënia në përdorim e kësaj sipërfaqe pyjore do sjell të ardhura vjetore për bashkinë, vlerën prej 1.465.178 lek.Gjithashtu për projekt vendimin e mësipërm është realizuar dëgjese publike me datë 15.12.2023 me banorët e fshatrave Kosmaç dhe Stajka, të cilët kishin shprehur dakortësi për projekt vendimin.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për z. Pjeter Zefi dhe z. Paulin Bisha në programin e strehimit “Subvencionit të qirasë në tregun e lirë”

Fjala për të relatuar i jepet Z.Edmond Gjeçaj- specialist pranë zyres së strehimit social, Bashkia Vau Dejës, i cili relaton për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit nga ku subvencionit i qirasë është një instrument që mbështet individë/familje që me të ardhurat e tyre nuk perballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë.Prandaj pasi janë bërë

të gjitha verifikimet në terren propozojmë se për z. Pjeter Zefi dhe z. Paulin Bisha duhet të bëhen perfitues te programi i subvencionit të qirasë në tregun e lirë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:**

Raport mbi performancën ekonomiko-financiare dhe aktivitetin e shoqërisë “Zadrime Agrikulturë” shpk.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Sabah Ymeri- administrator i shoqërisë “Zadrime Agrikulturë” shpk, i cili shpjegon se me fazën e parë të investimit për ngritjen e ambientit frigoriferik është bërë e mundur ndertimi i ndërtesës por për të realizuar kompletimin me pajisjet që do vëjnë në funksion këto pike grumbullimi të fruta perimeve kerkohen fonde të tjera.

Kjo shoqëri ka filluar aktivitetin si e regjistruar që në muajin Prill të vitit 2021 dhe vazhdon të jetë aktive. Unë jam administrator i kësaj shoqërie, pa asnjë punëtorë. Kam bërë kontakte të vazhdueshme me shumë aktorë të ndryshëm që operojnë si në fushën e prodhimit ashtu edhe në drejtim të menaxhimit të shoqërive të tilla. Kerkohet që ky ambient të kompletohet me pajisjet që nevojiten për realizimin e qëllimit që ka shoqëria por aktualisht nuk është në funksion.

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:**

Të ndryshme:

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për të ngritur pyetje apo diskutime për shqetësimet që ato kanë hasur.

Z.Neki Kapllanaj ngre shqetësimin se në fahatin Mjedë janë djegur disa llampa ndriçimi dhe se kerkohet rregullimi i tyre.

Z.Ervis Molla-Zv/Kryetar Bashkie, premtan se shumë shpejt do të nderhyhet për rregullimin e tyre.

Znj.Lenora Prenga ngre shqetësimin se në shkollën e Hajmelit duhet të nderhyhet për të bërë sistemimin e oborrit të shkolles.

Z.Ervis Molla premtan se do të bëhet e mundur shumë shpejt që ky problem të zgjidhet menjëherë dhe se do ta diskutoj edhe me Kryetarin e Bashkisë këtë shqetësim tuajin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pyetje apo diskutime të tjera nuk kishte, mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës e datës 24.05.2024 deklarohet e mbyllur nga kryetari këshillit.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

*Feris Sinaj*  
*Melika Zyheri*  
*Leonora Proença*  
*Neli Topllanaj*  
*Ferizo Kula*  
*Rita Gresi*  
*Muhamet Proença*  
*Ornela Lleshi*

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_